

THE SPANISH LANGUAGE TEACHING IN ALBANIA AS A FACTOR OF INTEGRATION INTO EUROPE

MËSIMDHËNIA E GJUHËS SPANJOLLE NË SHQIPËRI SI FAKTOR INTEGRIMI NË EVROPË

VIOLA BITI GJYLI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaja, Depratamenti i Spanjishtes, Tiranë, SHQIPËRI
vgjyli@yahoo.it

AKTET V, 4: 758-762, 2012

PERMBLEDHJE

Mësimi i gjuhëve të huaja është një faktor kyç në integrimin Evropian. Mësimi i një gjuhe të huaj tregon një interes drejt diversitetit kulturor evropian. Ky punim do të tregojë se si është rritur interesi i gjuhës spanjolle në Shqipëri gjatë viteve të fundit, i cili jo vetëm ka sjellë diskutime pozitive në procesin e mësimdhënies, dhe një rritje të metodologjisë mësimore, por edhe ka rezultuar në një rritje të dukshme të aftësive me shkrim e me gojë për studentët tanë. Do ti kushtohet vëmendje Kompetencës Gjuhësore e cila i jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e tyre mbi gjuhën spanjolle. Gjithashtu kjo kompetencë i drejton aftësitë e studentëve për të përdorur këto njohuri për të interpretuar dhe për të prodhuar tekste kuptimplotë. Ky punim do të përfshijë disa të dhëna në shifra mbi situatën gjuhës spanjolle në Evropë. Fakti që gjuha spanjolle zë vendin e dytë në botë përsa i përket komunikimit dhe gjithashtu është gjuha e pestë e Bashkimit Evropian për nga numri i folësve nativë, i jep një rëndësi të veçantë futjes së kësaj gjuhë në kurrikulat dhe programet mësimore në Shqipëri.

Fjalet kyce: kurrikula, Kompetencë Gjuhësore, mësimdhënie e gjuhës spanjolle, integrim.

SUMMARY

Foreign Language learning is a key factor in European integration. Mastering other language shows openness towards Europe's cultural diversity. This thesis explores how Spanish language has developed last years in Albania and has not only stimulated a productive discussion of teaching objectives, methods, and underlying rationales that are now reflected in curricula and textbooks, but also has resulted in increased oral and written proficiency for our students. Some consideration will be given to the Language Competence that gives to the students the opportunities to develop their knowledge of the Spanish language. Also this competence addresses their abilities to use that knowledge to interpret and produce meaningful texts. This thesis will include some data in the figures on the Spanish language situation in Europe. The fact that Spanish language occupies the second place on the world communication and also it is the fifth language of the European Union by number of native speakers, gives a special importance in introducing this language in the teaching curricula in Albania.

Key words: Curricula, language competence, Spanish teaching, integration.

1. Hyrje

Në ditët e sotme gjuha spanjolle është gjuha e tretë më e njohur dhe e folur në nivel botëror dhe kjo arësye e paraqet të domosdoshëm integrimin e saj në eksperiencat tona gjuhësore. Edhe pse gjuha angleze është ende më e përdorur, gjuha spanjolle vazhdon rritjen e saj të pandalshme në të gjitha vendet e botës. Gjuha e

huaj në përgjithësi dhe ajo spanjolle në veçanti ka një mision të veçantë sidomos në momentet aktuale kur vendi ynë aspiron të futet në Evropë dhe tendenca kryesore është krijimi i një mjedisi plurilinguist e multikulturor.

Gjuha spanjolle është duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme në të gjithë Evropën dhe pesha e saj është duke u bërë mbizotëruese dhe duke lënë

pas atë të gjuhëve të tjera. Nëse marrim parasysh për sa është përmendur më sipër, nuk është e çuditshme që numri i studentëve që kanë zgjedhur për të studiuar gjuhën spanjolle, duke e preferuar atë nga gjuha gjermane e franceze që konsiderohen tradicionalisht më të rëndësishme, është në rritje e sipër.

2. Disa të dhëna mbi përhapjen dhe shtrirjen e gjuhës spanjolle nëpër botë

Spanjishtja është një Gjuhë Latine e folur në gadishullin Iberik dhe në disa vende të Amerikës Latine. Kjo është një nga gjuhët e para të Tokës nga numri i banorëve: 500 milionë aktualisht.

- Gjuha spanjolle është gjuha e tretë më e folur në botë, pas asaj kineze dhe angleze; dhe zë vendin e dytë përsa i përket përdoruesve të saj si gjuhë amtare.
- Gjuha spanjolle së vendin e pestë në vendet e Bashkimit Evropian për nga numëri i folësve nativë.
- Në fund të shekullit XIX, ishin rreth 60 milion përdoruesit e kësaj gjuhe, tashmë në të gjithë botën janë rreth 500 milion persona që e flasin gjuhën spanjolle.
- Spanjishtja është gjuha amtare e rreth 338 milion personave në 21 vende. Gjithashtu flitet edhe në nivel botëror në vende të tjera ku nuk është gjuhë zyrtare.
- Në lidhje me përhapjen e saj, është një nga gjuhët më premtuese. Sipas disa studimeve, në fakt, ka 16.429 botime të ndryshme, 254 kanale televizive dhe 5112 stacione radio.

Këto të dhëna janë sigurisht argumente bindëse, që tregojnë se ekziston një përfshirje e madhe e spanjishtes nëpër botë: si në përkthime të dokumenteve, të teksteve, të konferencave ndërkombëtare etj.

Shtrirja botërore e spanjishtes, i jep rëndësi të veçantë futjes së saj në programet mësimore në Shqipëri.

3. Zhvillimi dhe interesi i treguar mbi gjuhën spanjolle si gjuhë e huaj ne Shqipëri

Interesi mbi njohjen e gjuhës spanjolle dhe kulturën e saj është në rritje nga viti në vit. Ky faktor tregohet nëpërmjet rritjes së numrit të

regjistrimeve mbi këtë gjuhë. Pikërisht kjo nevojë diturie mbi gjuhën spanjolle, i hapi rrugë krijimit të Departamentit të po kësaj gjuhe në Tiranë. Universiteti i Tiranës ka ndërmarrë një sërë hapash për përhapjen e studimeve hispanike dhe ka treguar një qëndrim të favorshëm mbi zhvillimin e gjuhës spanjolle. Tashmë është viti i katërt që ky departament është në funksion të studentëve shqipëtarë. Gjuha spanjolle ishte e pranishme në programin mësimor si lëndë fakultative që nga viti akademik 2005/06. Në janar 2009, qeveria shqiptare ka miratuar hapjen e Departamentit të Gjuhës Spanjolle. Viti akademik 2010 – 2011 shënoi, për herë të parë, edhe mbylljen me sukses të ciklit të parë trevjeçar, ku studentët tanë u diplomuan në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik.

Një rol të rëndësishëm ka luajtur ambasada spanjolle me anë të shtimit të aktiviteteve në këtë fushë dhe vënies në dispozicion të pedagogëve partnerë spanjollë për sektorin e gjuhës spanjolle në Shqipëri. Gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në përforsimin e mësimdhënies duke bërë të mundur që personeli akademik mësimor i Departamentit të Gjuhës Spanjolle të marrë pjesë në kurse të ndryshme trajnimi dhe specializime që lidhen me gjuhën spanjolle dhe mësimdhënien e saj nëpërmjet bursave të ofruara nga qeveria spanjolle.

Për gjatë një viti, Mars 2010 – Mars 2011, Katedra e Spanjishtes zhvilloi me sukses projektin e përforsimit të mësimdhënies së gjuhës spanjolle, të planit të studimit dhe të trajnimit të stafit akademik. Ky projekt u mundësua nga Universiteti i Tiranës (UT) në bashkëpunim me Universitetin Internacional Menendez Pelayo (UIMP) i financuar nga Agjencia Spanjolle e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Ky projekt kishte si objektiv kryesor përmirësimin e mësimdhënies dhe gjithashtu synoi të nxisë Departamentin e ri të Studimeve Hispanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të rëndësishme për zhvillimin e kurrikulumit dhe trajnimit e vazhdueshëm të pedagogëve. Ky projekt mundësoi dhe mbështeti katedrën tonë me asistencë teknike, aktivitete kulturore, trajnime,

si dhe sigurimin e materialeve dhe pajisjeve didaktike. Të gjitha këto patën një ndikim në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës spanjolle.

Një tjetër element themelor që ka cilësuar zhvillimin e mësimdhënies së gjuhës spanjolle është Kurrikula e gjuhës spanjolle e cila, drejton dhe ndjek procesin mësimor të studimeve hispanike pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Kjo kurrikul është hartuar duke patur parasysh interesat nxënësve të kësaj grupmoshe, të shprehura këto në tematikat e sferave të ndryshme, ai përshkohet nga objektivi kryesor: komunikimi në gjuhë të huaj në situata të ndryshme.

Për të parë interesimin e studentëve mbi këtë gjuhë është bërë një mini sondazh.

Pyetjeve se: *“përse ju tërheq gjuha spanjolle?; për çfarë ju shërben?; dhe çfarë shikoni të vecantë tek kjo gjuhë?”*, studentët tanë i janë përgjigjur në forma nga më të ndryshmet:

– Për numrin e madh të latinoamerikanëve që janë sot.

– Sepse jetojmë në një botë shumëkulturore.

– Sepse është një gjuhë botërore, dhe duhet të përfshihen shumë vende të tjera, përveç Spanjës, ta flasim këtë gjuhë.

– Me zbulimin e internetit, gjuha spanjolle shërben për të komunikuar me botën hispane.

– Në ditët e sotme ka lindur nevoja të lëvizim në një kontekst global si në botën e biznesit ashtu edhe në atë akademike.

– Sa më e madhe dhe më e gjerë të jetë experienca gjuhësore aq më e gjerë do jetë njohja kulturore mbi po atë gjuhë.

– Të njohësh gjuhën spanjolle arrin të shikosh edhe ndryshimet që ka ajo me gjuhët e tjera.

– Është e rëndësishme të përballesh më prononcimin e një gjuhe të re dhe të mund të mësosh mbi përdorimet gramatikore që disponon gjuha spanjolle.

– Sepse bukuria qëndron në shumëllojshmërinë e gjuhëve.

– Sepse na hap shumë porta kulturore, mësimi mbi gjeografinë, historikun, lëtërsinë e kësaj gjuhe.

– Sepse thjesht duam të udhëtojmë drejt vendeve ku flitet gjuha spanjolle.

– Sepse përforcohet imazhi i kësaj gjuhe në një botë ku dominon kryesisht gjuha angleze.

Për të konkluduar me këtë kapitull, ne vetëm mund të citojmë disa fjalë të Hernandez-Chávez, edhe pse ato i referohen kontekstit të zhvillimit të gjuhës spanjolle në Shtetet e Bashkuara na bëjnë të reflektojmë të gjithë ne pedagogët e gjuhës spanjolle si gjuhë e huaj: *“Objektivat e rigjallërimit të gjuhës spanjolle nuk mund të ndahen nga ato të pluralizmit kulturor”* (Hernández-Chávez, 1993: 67). Vizioni ynë për të ardhmen e mësimin të spanjishtes si gjuhë e huaj duhet të jetë i përshtatur brenda këtij pluralizmi kulturor, dhe një nga objektivat e saj duhet të jetë zhvillimi i kompetencës ndërkulturore të studentëve tanë. Prezantimi i kësaj gjuhe me gjithë pasuritë e saj gjuhësore dhe kulturore është e vetmja rrugë, detyrë dhe alternativë që ne pedagogët e gjuhës spanjolle si gjuhë e huaj, duhet të ndjekim.

4. Mësimdhënia dhe nxënia e gjuhës spanjolle si gjuhë e huaj

Pedagogu luan një rol të rëndësishëm në formimin e studentit. Në udhëzimet e Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja, Këshilli i Europës paraqet një linjë të përbashkët përse i përket mësimdhënies / nxënies së gjuhëve të huaja, tek e cila duhet të ndalojmë e të reflektojmë se si mund të përmbushim nevojat e studentëve. Duke punuar mbi zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe ndërkulturore, duke krahasuar gjuhën mëmë me atë të huaj, në rastin konkret me atë spanjolle, pedagogu do të mund të cojë studentin drejt një kompetence plurilinguistike dhe multikulturore.

4.1 Zhvillimi i Kompetencës Gjuhësore

Kompetencë Gjuhësore është një term i gjerë që përfshin jo vetëm njohuritë për gjuhën, por edhe aftësinë për të përdorur atë njohuri për të interpretuar dhe për të prodhuar tekste kuptimplotë të përshtatshme për situatën në të cilën ato përdoren. Kompetenca gjuhësore është zhvilluar më mirë në kontekstin e aktiviteteve

apo detyrave ku gjuha është përdorur për qëllime të vërteta, me fjalë të tjera, në të gjitha kërkesat praktike. Detyrat i përfshijnë studentët në të kuptuarit, në manipulimin, në prodhimin, apo të ndërveprojnë në spanjisht, ndërsa vëmendja e tyre është e përqendruar kryesisht më shumë në kuptimin e gjuhës spanjolle se sa në formën e saj. Aktivitetet ose detyrat zgjidhen në bazë të nevojave, interesave, dhe përvojave të studentëve. Fjalori, gramatika, struktura, forma dhe tekstet, mësohen, ushtrohen dhe vlerësohen prej studentëve tanë. Kjo gjë i shtyn ata drejt një pavarësie të zhvillimit të kompetencës së gjuhës.

4.2 Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore

Kompetenca ndërkulturore është një kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të cilat u mundësojnë individëve të komunikojnë dhe të ndërveprojnë përtej kufijve kulturorë. Në programin e gjuhës dhe kulturës spanjolle, këto kompetenca përfshijnë aftësitë për të gjetur informacion rreth kulturave spanjisht-folëse, duke e interpretuar atë në mënyrë që të kuptojmë besimet, traditat dhe vlerat kulturore të popullit hispanik, dhe duke e lidhur e duke e krahasuar atë me kulturën shqiptare. Në procesin e zhvillimit të kësaj kompetence, studentët do të përfitojnë njohuri të aspekteve të ndryshme të këtyre kulturave, si dhe njohuri mbi proceset e bashkëveprimit në mes dy kulturave. Me zhvillimin e kësaj kompetence, studentët do të arrijnë të rrisin njohuritë, do arrijnë të jenë më të hapur dhe të gatshëm për të parë botën nga pikëpamja e të tjerëve. Kultura në këtë program është përcaktuar si një kontekst i përgjithshëm dhe si një mënyrë jetese: sjelljet dhe besimet e një komuniteti historia, gjeografia dhe institucionet e të cilëve janë të ndryshme dhe i bëjnë t'i dallojnë ato në një shkallë më të lartë ose më të ulët nga të gjitha grupet e tjera.

Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore mund të bëhet në tri kontekste: në klasë, në terren, ose si një përvojë të pavarur. Në **klasë**, aktivitetet janë të planifikuara dhe të strukturuara nga mësuesi dhe zakonisht marrin formën e një prove bashkëvepruese në kohë reale. Në klasë, studentët kanë mundësi të zbulojnë dhe

analizojnë kulturën e gjuhës së huaj, e në rastin konkret asaj spanjolle, duke reflektuar e duke marrë informacion nga guida e tyre, pedagogu. Me fjalë të tjera, atyre nuk u duhet të japin përgjigje të menjëhershme. Në **terren**, aktivitetet janë ende të planifikuara dhe strukturuara, por bashkëveprimi është tani në kohë reale. **Përvojat e pavarura** janë ato të kryera nga vetë studentët jashtë strukturës së kursit. Janë këto të fundit në të cilat studenti vë në jetë dijet e përthithura duke bërë kërkime të ndryshme kulturore. Kërkimet mund të jenë objektet e thjeshta kulturore si: tekste të vjetra, veshjet, ushqimet, muzika, objekte të përditshme, vepra artizanale, etj. Këto materjale janë të dobishme dhe vlejné si një urë për krijimin e më shumë ideve abstrakte. Pra nëpërmjet kompetencës ndërkulturore student i bëhet i vetëdijshëm që kultura e një gjuhe të huaj është e shprehur përmes formave të ndryshme, jo vetëm nëpërmjet letërsisë klasike apo arteve të bukura.

5. Konkluzione

Spanjishtja është duke u bërë gjuha e së ardhmes dhe zhvillimi i saj është i dukshëm në cdo cep të vendit. Pra, studimi i saj do të thotë një investim në të ardhmen. Përveç arsyeve të biznesit, me njohjen e kësaj gjuhe arrihet të kuptohet më mirë kultura e saj dhe e popujve latinë. Pasioni spanjoll është “infektues”, dhe sapo fillon të zbulosh gjuhën dhe traditat kulturore, nuk do jetë e lehtë të lëshosh nga duart një pasion të tillë.

Bibliografia

ALFARO, María Noemí – RODEA, Marisela Corin (2008), *La investigación-acción y formación teórica crítica del docente de lenguas extranjeras*, Universidad Autonoma de Mexico.
ALONSO, Encina (2007), *Como ser profesor/a y querer seguir siéndolo*, Edelsa, Madrid.
FERNÁNDEZ, Francisco Moreno y ROTH, Jaime Otero (2007), *Atlas de la lengua española en el mundo*. Barcelona: Ariel-Fundación Telefónica.
HERNÁNDEZ –CHÁVEZ , E. (1993): *Native Language Loss and its Implications for Revitalization of Spanish Communities*, London, The Falmer Press.

PINAL, Gloria Estela BAEZ (2007), *La enseñanza del español. Problemas y perspectivas en el nuevo milenio*", Mexico, UNAM.

PINAL, Gloria Estela Baez (2007), *La enseñanza del español. Problemas y perspectivas en el nuevo milenio*", Mexico, UNAM.